



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 32**

**Datë: 30. 11. 2023. Ora: 13:30**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.**

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

**RENDI I DITËS**

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së
2. Aktivitetet e Zyrës
- 3.Rekomandim për pezullim e partisë politike DEMOKRATSKA STRANKA BOŠNJAKA.
- 4.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për Organizimin e punëtorisë për Rregulloret e Brendëshme të KQZ
5. Të ndryshme !

---

**1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

Në fillim të mbledhjes kryetari Radoniqi paraqiti pikat e mbledhjes ndërsa Arianit Elshani tha se çështja e organizimit të punëtorisë për planin e punës, dokumentet kalojnë në këshilla. Pra, dokumenti të kalojë në këshillin për personel, e pastaj të vie në mbledhje. Paraprakisht, të na dërgohet gjithë materiali dhe pastaj, ne pastaj ta shqyrtojmë.

**Ibrahim Selmanaj**, tha se ka kohë që nuk kemi mbajtur tamin, prandaj mendoj që të shqyrtohet prapakisht.

**Sami Hamiti**, tha se, po është e drejtë që ne njëherë ta shqyrtojmë në personel, ta shihim si anëtarë dhe pastaj, ta kemi në punëtori.

**Iir Gashi**: Këshilli duhet me trajtue, ashtu si i kemi trajtue rregullat. Pra, pavarësisht brimit që e kaba eksperti. Nuk po votoj pse nuk ka shkue në këshill, por me u trajtue atje. Kur ti jepet viza, atëherë në rregull. Pra, po e jap edhe si rekomandim se si duhet të jetë rruga...

**Arianit Elshani**: Nuk po due me përfundue puna qysh kan përfundue rregullat zgjedhore, konsideroj që puna në punëtori, është një takim i përbashkët ku përfundon “puna finale” dhe që, në parim i miratojmë dokumentet...

**Čemailj Kurtiš**: Falemnderit. Në parim, pajtohem me ato që thanë diskutuesit sepse, duhet që ne të jemi të informuar për diçka që duhet të jemi të informuar! Pra, të dim si po shkojmë në punëtori. Kurse, pika tjetër rekomandimi për “pezullim e partisë politike Demokratska stranka Boshnjaka”, të prolongohet afati për mbajtjen e kuvendit.

**Kreshnik Radoniqi**: Për momentin, rekomandimi është i zyres dhe kur ta diskutojmë si pikë, atëherë e shqurtojmë, por tani ky s’është propozim yni, është i zyres...

Në vazhdim, u propozua që “pika nr. 4” të hiqet nga rendi i ditës. Me 9 vota për dhe 1 abstenim, u mriatua agjenda e mbledhjes.

## **2. Aktivitetet e Zyrës !**

**Benik Buzhala**, drejtor i ZRCKFSP, tha se zyra ka zhvillaur dy aktivitete: E para, ka të bëjë me shtyrtimin ppublikimi për regjistrimin e partisë politike “Srpska Demokratija”. Sipas vlerësimit të zyrës, aplikimi është në rregull. Dokumentacioni është i kompletuar sipas paragrafit 4, të nenit 3 të Rregullores Nr. 01/ 2023. Ndërsa, sipas paragrafit 4, të nenit 3 të Rregullores Nr. 01/ 2023, secili qytetar i Republikës së Kosovës, mund ta kundërshtoj kërkesën në bazë të një ose më shumë

arsyeve të parashtruara, duke i dorëzuar kundërshtimet me shkrim në zyrë, së brenda shtatë ditëve nga shpallja e kërkesës.

Kërkesa për shqyrtim publik, tha Buzhala shpallet në ueb faqen e KQZ nga 29.11.2023, deri më 5 dhjetor. Nëse nuk ka kundërshtime, sipas procedurave ligjore të zyrës ne do ta rekomandimin në KQZ, për regjistrim.

Më tej, Buzhala tha se procesi i auditimit të raporteve financiare të subjekteve politike për vitin 2022 ka përfunduar, dhe se auditori na e ka dorëzuar të gjitha raportet përfundimtare të auditimit. Këto raporte janë publikuar në ueb faqen e KQZ dhe, u janë dorëzuar edhe partive politike.

Janë audituar 52 subjekte politike.

**Ilir Gashi**, si di, nëse e kemi në imell dokumentacionin e këtij subjekti (statuti, programi etj. )...?

**Besnik Buzhala**: Programi, statuti dhe dokumentet tjera janë të publikuara në ueb faqe. Kërkesat formale, janë plotësuar, tani janë në shqyrtim.

**Ilir Gashi**: Ne, duhet ta kemi dokumentacionin. Në imell....! Po dua të ju besoj, nuk ka problem por unë personalisht, nuk e kam pa. Si vërejtje: nuk është ueb faqja ku ne duhet ta shohim materialin, duhet ta kemi në imell...

**Arianit Elshani**: Lidhur me dokumentacionin e dorëzuar, cili do subjekt qoftë, statuti, programi duhet të na sillet në dy gjuhë, të na përkthehet ...

Në anën tjetër, duhet komunikuar më shumë me publikun në rastet e aplikimit të subjekteve të reja politikë, më shumë ti kushtohet vëmendje aspektit të informimit nga zyra...

**Rekomandim për pezullim e partisë politike “DEMOKRATSKA STRANKA BOŠNJAKA”**

**Besnik Buzhala** tha se sipas rregullores nr. 01/ 2023 për Regjistrimin dhe Funksionimin e Partive Politike, është praktikë që partitë politike të obligohen, si në veprimet si në vijim: Të mbajnë kuvendin e partisë së paku çdo dyzet e tetë muaj për të zgjedhur kryetarin, dhe organet tjera të partisë; ta informojnë zyrën, se kanë mbajtur kuvendin, duke dorëzuar dokumentet e kuvendit të

përcaktuara në këtë rregullore. Në lidhje me këtë, partia politike “Demokratska stranka bosnjaka”, me akronimin DSB, e cila është e regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me datën 04.07.2001, ka qenë e obliguar që Kuvendin e radhës ta mbajë me datën 16.11.2023. Kuvendin e fundit të partisë, ky subjekt e ka mbajtur qysh më 16 nëntor, 2019.

Zyra nuk ka pranuar njoftim për mbajtjen e Kuvendit apo ndonjë kërkesë për shtyrje të kuvendit, prandaj ky subjekt nuk e ka respektuar afatin e fundit për ta organizuar dhe mbajtur kuvendin. Në bazë të kësaj, Zyra i rekomandon KQZ që ta pezullojë këtë parti, bazuar në nenin 5 të rregullores nr. 01/ 2023 për Regjistrimin dhe Funksionimin e Partive Politike. Ky subjekt, obligohet që afat prej dyzet e pesë ditësh, ta mbajë kuvendin. Në të kundërtën, duhet të c’regjistrohet nga regjistri i partive politike.

**Arianit Elshanaj**, pyeti se kur është bërë komunikimi i fundit me këtë subjekt, a janë njoftuar ata për afatin, dhe nëse keni pranuar apo jo ndonjë kërkesë...

**Besnik Buzhala**: Zyra nuk ka për obligim që t’ua kujtoj aptive kur e kan kuvendn. Subjektet, 5 ditë para mbajtjes së kuvendit të tyre, janë të obliguara që ta informojnë zyrën detajisht për mbajtjen e kuvendit: vendi, koha etj. Masa pezulluese nuk është masë ndërshkuese, por është masë paralajmëruese: i bahet me dije që ka 45 ditë për mbajtjen e kuvendit.

Kemi pranuar një kërkesë të kryetarit të këtij subjekti me 29. 11. 2023 për shtyrjen e kuvendit, diku në muajin mars 2024 dhe se ai, ka dhënë arsye si kushtet atmosferike, mundësitë e vështira të organizimit për shkaqe se shumica e degëve dhe nëndegëve janë nëpër fshatra të thella malore... Kërkesa është e vonuar, sepse është dashtë të bëhet 10 ditë para datës së 16 nëntorit...

Janë edhe disa subjekte që kanë pasur të mbajnë kuvend, por nuk po them asgjë por është mirë që ju edhe mund ti paralajmëroni, t’ua komunikoni edhe kur e kanë kohën e mbajtjes së kuvendeve sepse, ju komunikoni si me raprote etj. Por, ënse nuk është e rregullueme kjo, mbase do duhej të ishte me rregullore...

Partia Rome e Bashkuar e Kosovës a e ka mbajtur kuvendin ?

**Besnik Buzhala**, tha se për shkak të arsyeve të rënda shëndetësore të kryetarit Albert Kinolli, zyra e ka arsyetua mos mbajtjen...Arsyet, janë familjare ?

**Ilir Gashi:** Kush ka vendosë...?

**Besnik Buzhala:** Jo, zyra për shkak të arsyeve shëndetësore...

**Ilir Gashi:** Ky, është një rast i ri. Zyra, ka gabue në veprimin e vet...! Nëse janë kalue afatet dhe zyra, pa e sjellë në KQZ me gjithë arsyet, është dashur të vijë te ne dh të vendosim...Jo, ky është një precedent...

Zyra, nuk ka autoritet me ja vazhdue ose jo mbajtjen, zgjatjen e kuvendit zgjedhor...!

Në këtë pikë, foli edhe **Sami Hamiti** tha se ka “ një histori” në këtë drejtim, madje edhe subjekti im ka pasur një kërkesë të këtillë, por ne kemi vendosur...! Po na dalë që kemi kërkesa, kurse brenda zyrës është vendosur ti jepen gjashtë, kurse ne tash na sillet një kërkesë tjetër e njëjte, veç e një subjekti tjetër...

**Čemailj Kurtiș:** Unë do të ju lutesha që, para se gjithash, është bërë gabimi nga subjekti që i takoj. Është bërë gabimi te personi ynë teknik, ne kemi rreth 34 vite përvojë, nuk kemi pasur probleme. Ka pasur praktikë të lajmërimit nga zyra për mbajtjen e kuvendeve, tash nuk e di, prandaj na jepni mundësi sepse, ne do ta mbajmë kuvendin. Por ne kemi 16 degë në fshatra të thella malore, probleme me rrymën, probleme teknike etj. Këto janë kushte të rënda, ftohtë etj. Prandaj, ju lus ta prolongoni rekomandimin dhe ne do ta mbajmë kuvendin...

**Sami Kurteshi:** Ju lus që kur të punoni me rregullore, dhe ne s’do të humbim kohë! Nëse e caktojmë një afat, dihet por krejt ajo që duhet të veprojmë, në bazë të ligjit... Ne, duhet të jemi krejtësisht tolerant ndaj partive politike, madje edhe në ligj ka tolerancë por ne duhet t’i respektojmë rregullat, ligjet..

Me rregullore, të gjitha mund ti rregullojmë! Unë jam të jemi të hapur, tolerant me partitë mirëpo janë do rregulla që ata vet i shkruajnë në statut. Nëse ata nuk i respektojnë, ne e kemi problem pastaj...

Unë se kuptova mirë kërkesën e kolegët...? Ju po kërkonit deri në mars...se, nuk e kuptova...!

**Arianit Elshani:** E shfletova edhe rregulloren e zyrës, pra ne kemi parapa edhe mundësinë e zgjatjes së kuvendit, por ne duhet ti informojmë partitë edhe me obligimit por edhe të drejtat e

tyre....Mbasi që ende si kemi përfundua rregulloret, edhe subjekti në fjalë, të njoftohet se mundet deri më datën 15, dhe të ketë një bazë...

**Ibrahim Selmanaj**: Katër dhjetë e pesë ditë, subjekti e ka të drejtën e organizimit të kuvendit. A ka të drejtë 45 ditë, mbas sodit...!

**Besnik Buzhala**: Nëse merret vendimi - prej pranimit të vendimit i ka 45 ditë...!

**Kreshnik Radoniqi**: Janë disa çështje. Së pari, zyra nuk ka faj dhe nuk duhet as me u kritikua. Zyra i ka krye detyrat e veta. Në këtë rast, nuk kemi obligim me komunikue me partisë. Së dyti, çështja e pezullimit – nuk e kemi pezullue se nuk i ka marrë votat, nuk e kemi pezullue... Tash, nëse partia në fjalë nuk i ka përmbush rregullat ne s'kemi faj, kurse në rregulloren që e kemi votue këtu, nuk janë këto "arsye" që mundet me u shtye...Janë të precizuara në rregullore se cilat janë arsyet...Këto, nuk janë asnjëra prej arsyeve që po thua ti...

Unë, nuk e votoj idenë e shtyrjes, as nuk e qes në votim ! Po, deri sa këto arsye nuk shkruajnë askund, unë se përkrahu...

Ne, tha z. Radoniqi, e kemi pezullue ni parti në rrethana identike...Nuk ka KQZ këtu asgjë, janë partitë ato që kanë obligim...

Tash, me rëndësi është që ne ti respektojmë rregullat që i kemi miratua vet. Nuk ka asnjë mundësi me u shtye, me vota është tjetër gjë, munde – s'mundet por, sa i përket mundësisë së zbatimit të rregullores nuk ka hapësirë...Unë, nuk e shkruaj atë vendim, unë e aplikoj atë që është në ligj, në rregullore...

**Arianit Elshani**: Nga diskutimi doli që një subjekti që i është shtye deri në janar, dhe ato pika nuk kanë bazë, dhe kjo nuk ka kalue fare në KQZ...! Fjala është për Partinë Rome të Bashkuar...! ( Kjo çështje u shqyrtua dhe u sqarua në mes të z. Kreshnik Radoniqi dhe Arianit Elshani).

Në këtë pikë diskutuan: **Sami Kurteshi** i cili gjykoj se "vendimi", cili do duhet të mbështete vetëm në ligj. **Ilir Gashi** tha se edhe kuvendi i Kosovës e ka një rregullore, por ka momente kur ai kuvend vendos për "shmangie" nga rregullorja...! Kemi precedent, raste ( partia Guxo, partia Republikane etj.). Po me këtë rregullore unë kam mbështetë raste...

**Fazli Stollaj**: Vitin e kaluar ka qenë rasti me PAI ! Por, kërkesa ime ishte që tu shtyhet 45 ditë...

**Gordana Llaban:** A ka pas obligim zyra që ti informoj partitë për mbajtje të kuvendeve...? Jo, ne i kemi mësua, pra nëse i kemi lajmërua në të kaluarën duhet. Por, nëse s'i informoni sot, është dashur tu dërgoni ni imell dhe t'u tregoni se tash e tutje nuk informohen nga zyra...

**Čemailj Kurtiš:** Thash që, ka qenë një praktikë e mirë që të informohen partitë, janë informuar...! Unë, thash se nëse mundet të prolongohet kjo deri në mars, nëse mundet...!

**Mufera Shinik:** Nëse kemi mirëkuptim ka precedent, unë jam të votoj që deri në mars të shtyhet...!

**Kreshnik Radoniqi:** Mirë, e hedh në votim: Kush është për rekomandimin e zyrës që të pezullohet partia politike: “Demokratska Stranka Boshnjaka”.

Me dy vota për, dhe të tjerët abstenuan....! Ky rekomandim, nuk u miratua.

### **Të ndryshme!**

**Kreshnik Radoniqi:** E keni parë një rregullore që e ka dërgua Besniku. Ne, duhet të takohemi edhe për te për ta diskutuar, shikoni...

**Gordana Llaban:** Në kampanjën e informimit identifikimi dhe ndërrimi i qendrës së votimit” nuk kemi video në gjuhën serbe ? Ka pasur më herët në gjuhën serbe por, tash nuk ka. Pse ka ndodhur, a mundet me u ditë...

**Arianit Elshani:** Agjencia për Informim dhe Privatës, e mora një informatë, çka ka ndodhur...?

**Sami Kurteshi:** Ne, e kemi këtë projekt shumë të mirë por aty ka të dhëna që, a janë të siguruara. Kush është institucioni që e bënë mbrojtjen e tyre...? Kemi të bëjmë me numrin personal, pra që të mos na del ndonjë problem duhet të informohemi me kohë...

**Kreshnik Radoniqi:** Po jam informuar pak më shumë...! Të dhënat personale, madje me fotografi kanë qenë të qasshme për këdo qoftë! Qasja a kanë...! Me një klik, mbi 2050 persona që kanë aplikue janë shfaqë...Kjo, është dashtë urgjentisht mu ndërpre...E kemi ndërpre sot...

**Burim Ahmetaj:** Kemi pasur takim për këtë çështje teknike, dhe është kërkuar që KQZ ta ketë një rregullore “për përpunimin e të dhënave, si mbrohen, kush është përgjegjës etj.”

**Kreshnik Spahiu**, tha se problemi te “makina kërkuese” ka pas një lëshim. Është diku në sistem...Një llogari e përdoruesit të sistemit, ka qenë një “qasje e pa autorizuar” që ka qenë në sistem...Nuk ka qenë kjo qasje publike, por jemi duke e analizue se çka ka ndodh...!

Kjo i bje se, dikush ka mund ta krijoj “një llogari” që të krijoj qasje dhe ka mund të hyjë në “linkun e fshehur” me i pa të dhënat.... Platforma ka qenë e destinueme edhe për shërbimet tjera si Akreditimi i Vëzhguesve, dhe dikush ka mundur me kalue te “pamjet” e ndërrimit të qendrave të votimit...Praktikisht, ne e kemi ba de aktivizimin... ! Jemi duke punuar shumë që kjo të evitohet, dhe të kthehen ë normalitet...

**Ilir Gashi**: Unë e kam pas këtë dilemë që në fillim, sidomos për palët se kush duhet të ketë qasje, dhe unë mendoj që faqja është hakue...Pikë. Unë, jam pak i rezervuar te teknologjia...Pra, edhe ndaj votimit elektronik, e që nesër mund ti hakoj edhe rezultatet e ku di unë...

Sa kemi me qenë të sigurt...? Është çështje kjo...

**Sami Kurteshi**: Deri në mbledhjen e ardhshme, a mund ta keni një raport që ta dimë se çka ka ndodhur...? Ne, me u informua edhe për takimin me agjencinë... Na i sillni të gjitha rekomandimet, mandej ne me marrë vendim. Atëherë, fillon përdorimi i softuerit...

**Arianit Elshani**: Qasje, aktualisht kush ka pasur deri tani për shqyrtim dhe provim të kërkesave...?

**Kreshnik Spahiu**: Zyrtari i Listës Votuese dhe Zyrtari i Bazës së të Dhënave...

**Burim Ahmetaj**: Neve na është thënë nga agjencia e mbrojtës së të dhënave se, sistemi nuk është aq i mbrojtur, nuk është imun dhe, ne jemi takue me ta dhe, na është kërkuar që ne të veprojmë menjëherë...brenda 24 orëve...

**Kreshnik Spahiu**: Ne, kemi komunikue me agjencinë, dhe pas ndërhyrjeve tona nga agjencia na është thënë se gjërat tash janë në rregull...

Në fund të mbledhjes, kryetari Kreshnik Radoniqi ( me kërkesën e z. Čemailj Kurtiŝ), edhe njëherë e diskutoi rastin e subjektit partiak boshnjak. Besnik Buzhala tha që, subjekti ta dërgojë një kërkesë zyrtare në zyre...



